



Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosova



Komuna e Kaçanikut

Opština Kacanik

Municipal Kacanik

01Nr. 16-9104/2014

Kaçanik, 31.03.2014

Në bazë të nenit 4, paragrafi 3 pika 3.3.13 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, të nenit 12, 14 dh 17 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 6.2 dhe 34.5 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 31.03.2014, mori këtë:

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E INTERESIT TË PËRGJITHSHËM PUBLIK PËR NDËRTIMIN E STADIUMIT TË QYTETIT

I.

Me këtë Vendim, shpallet interes i përgjithshëm publik për ndërtimin e Stadiumit të qytetit, dhe së lidhur me të mund të filloj procedura e shpronësimit.

Patundshmëria në të cilën do të ndërtohet Stadiumi i Qytetit-fusha ndihmëse, pargingu, rrugët lidhëse dhe infrastruktura e nevojshme përbëhet nga parcela kadastrale nr. 01311-0, në emër të Angjelko Ognjenoviq(Jovan) 1/4 nga Batoqinë, Millutin Ognjenoviq (Jovan) 1/4 nga f. Rekë, Radoslav Jovan Ognjenoviq 1/4 nga f. Rekë, dhe Sllagjana Popoviq (Milovan) gruaja e Mihajlit nga Beogradi dhe parcelat kadastrale nr. 01312-0, 01313-0, 01314-0 dhe 01315-0 në emër të Milenko Qalija(Dushan)1/6, Kragujevc, Zorka Kostiq(Vidak)1/6 Kragujevc, Vera Milutinoviq(Vidak)1/6 Mitrovicë, Novka Shapiq(Vidak) gruaja e Radojës 1/6 nga Zveqani, Zagorka Tomiq(Vidak) gruaja e Ilijës 1/6 nga Fushë Kosova dhe Dragan Vukoje(Mirko)1/6 nga Kragujevci, Zona Kadastrale Stagovë.

II.

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesën: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Arsime dhe Kulturë.

III.

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës.

IV.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Arsime dhe Kulturë, Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim dhe Arkiva.



Kryesuesi i Kuvendit,
Xhelal Gashi